
RECENSIONE

**DEMIR DYRMISHI: "LUFTA PËR PUSHTET NË UDHËHEQJEN
E PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE (PPSH), (1944-1960)"****300 f.***

Monografia e lartpërmendur përfaqëson punën disa vjeçare të Prof. Dr. Demir Dyrmishi, të hartuar sipas projekteve të Institutit të Historisë. Tema e saj është pjesë e fushës së studimeve të ndërmarra nga autori pas viteve '90. Për hartimin e saj janë shfrytëzuar gjerësisht burimet arkivore shqiptare, disa dokumente të arkivave ruse të përkthyer në gjuhën shqipe dhe burime të tjera të natyrës bibliografike. Kjo monografi përfaqëson një punim të plotë dhe të mirëdokumentuar të luftës në udhëheqjen e lartë të PKSH (PPSH) në vitet 1944-1960, periudhë gjatë së cilës Shqipëria kishte lidhje të ngushta me Jugosllavinë e Titos dhe me BRSS. Për këtë periudhë pothuajse mungojnë studimet shkencore të dokumentuara, pavarësisht nga ekzistenca e disa botimeve të natyrës së kujtimeve, që kanë dalë gjatë viteve '90 dhe më mbra. Përgjithësisht periudha e kohës së komunizmit në Shqipëri është shkruar duke u bazuar në botimet me kujtime të Enver Hoxhës, në veprat apo materialet e tjera të botuara nga PPSH, të cilat kanë përbërë esencën e studimeve të historiografisë shqiptare të kësaj kohe. Botimi i z. Dyrmishi zgjon interes sepse ndryshe nga botimet e para viteve 90, të shkruara pa ose me pak dokumentacion, "të servitur" dhe kontrolluar nga arkivistë, ka në bazë të tij një dokumentacion të gjerë dhe të plotë. Autori ka përfituar nga rrethanat e hapjes së arkivave tona, por edhe të vendeve të tjera ish-komuniste. Trajtimet e mëparshme kanë qenë thjesht një përsëritje, ritheksim apo rimarrje e ideve dhe shpjegimeve, që buronin nga udhëheqja e lartë e PPSH dhe nga forumet e larta të saj. Autori përmes këtij studimi është munduar të na japë një histori serioze, të dokumentuar, të shkruar me korrektesë shkencore.

Monografia e paraqitur për botim ka kaluar disa stadi, gjatë të cilave autori ka reflektuar dhe riparuar disa pjesë të saj, në bazë të këshillave dhe vërejtjeve të studiuesve të këtij Instituti, me qëllim që të përmirësohej më tej niveli i saj. Departamenti i Historisë Bashkëkohore i kërkoi autorit që të trajtonte dhe të fokusojë tek lufta brenda radhëve të PPSH, për shkak të gjerësisë së lëndës, të tematikës së veçantë dhe të interesit të përgjithshëm për të njohur më gjerë dhe më thellë këtë problem të patrajtuar më parë në planin monografik. Autori e mori parasysh këtë kërkesë dhe bëri objekt të studimit të

* Kjo recensë është shkruar para botimit të studimit.

vet, luftën e zhvilluar në gjirin e PKSH dhe PPSH, konfliktet e zhvilluara brenda llojit, të cilat në Shqipëri kanë qenë mjaft të ashpra, madje ekstreme krahasuar me vendet e tjera ish-komuniste të Evropës.

Monografia: *“Lufta në Udhëheqjen e Partisë Komuniste Shqiptare (PPSH), 1944-1960”* përbëhet nga: 6 kapituj, nga parathënia, pasthënia dhe nga bibliografia. Monografia është ndërtuar duke ndërthurur parimin kronologjik me atë tematik. Aty trajtohen konfliktet brenda udhëheqjes së lartë të PKSH (PPSH), duke filluar me Plenumin e Dytë të Beratit të nëntorit të vitit 1944, dhe përfundojnë me përplasjet brenda udhëheqjes së PPSH në vitin 1960, si pasojë e konfliktit dhe ndarjes së Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik. Pa dyshim monografia e Prof. Demirit përfaqëson studimin më të plotë të kësaj natyre, duke trajtuar pothuajse të gjitha ngjarjet e rëndësishme të kohës.

Ndër arritjet dhe vlerat e kësaj monografie, të cilat janë të dukshme, unë do të përmendja: Njohjen dhe shfrytëzimin deri në shterim të dokumentacionit shqiptar të vjelë nga Arkivi Qendror i Shtetit dhe ai i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Veçanërisht i dobishëm dhe me shumë interes për hartimin e kësaj monografie ka qenë shfrytëzimi i fondeve të PKSH dhe PPSH, me derivatet e tyre, si: ai i KQ të PPSH, Byrosë Politike, Sekretariatit të KQ, të Plenumeve dhe strukturave të tjera qendrore dhe lokale të tyre. Shumica e tyre prezantohen për herë të parë dhe në mënyrën më të plotë të mundshme. Por autori ka shfrytëzuar pjesërisht edhe botime të tjera dokumentare shqiptare apo të huaja, ndaj ndonjërisht prej të cilave ai ka edhe objeksionet e veta. Mbështetja e gjerë në burimet arkivore të pabotuara dhe të botuara, të kombinuara me literaturën historike të kohës, ka sjellë një studim me interes dhe origjinal. Monografia është hartuar me gjuhë të thjeshtë, të kuptueshme dhe pa ekuivokë, duke arritur në konkluzione që në jo pak raste janë të ndryshme nga ato të autorëve të tjerë.

Përgjithësisht monografia lexohet me endje, por disa pjesë të tij janë me të vërtetë shumë interesante. Gjatë leximit të saj do të ndeshesh me luftën e ashpër të zhvilluar brenda radhëve të udhëheqjes së lartë të PKS (PPSH), me eliminimet dhe dënimet maksimale të kundërshtarëve, sipas modeleve dhe metodave staliniste të kohës, të kombinuara këto me traditën dhe ashpërsinë shqiptare. Lufta brenda llojit ishte mjaft e ashpër dhe ajo ka sunduar sidomos pas vitit 1947 dhe në vazhdim, deri në rënien e regjimit komunist në Shqipëri.

Gjatë leximit të punimit të tërheqin vëmendjen disa konkluzione të autorit se, udhëheqja e PKSH (PPSH) kishte pothuajse unitet të plotë mendimi dhe veprimi për të realizuar objektivin e vet, likuidimin e “armiqve” jashtë radhëve të saj, se lufta brenda radhëve të saj nuk kishte të bënte me sistemin politik të zgjedhur dhe reformat e ndërmarra, por me luftën për pushtet dhe me garën që zhvillohej në udhëheqjen e lartë të PPSH për t’u ngjitur sa më lart në hierarkinë partiake dhe shtetëror. Lufta politike brenda radhëve të PPSH mendon autori, nuk synonte të ndryshonte sistemin ekonomik-shoqëror, i cili as që vihej në dyshim nga udhëheqësit komunistë të Shqipërisë, por synonte t’i

bënte disa makijazhe sistemit ekzistues, për ta bërë atë paksa më liberal dhe për të ndjekur hapin e vendeve të tjera komuniste, qoftë edhe atë të Jugosllavisë së Titos. Një arsye tjetër për kacafytje ishte objektivi për të rrëzuar Enver Hoxhën dhe pasuesit e tij nga drejtimi partiak dhe shtetëror i vendit dhe zëvendësimi i tij me një tjetër person dhe me të tjerë pasues në krye të Partisë dhe institucioneve shtetërore. Me këtë modul janë trajtuar dhe analizuar konfliktet brenda udhëheqjes së lartë të PPSH gjatë periudhës së ndërhyrjeve jugosllave, duke filluar me Sejfulla Maleshovën, Nako Spirun, Koçi Xoxen, por edhe më vonë në luftën ndaj Tuk Jakovës, Bedri Spahiut, Liri Gegës, Liri Belishovës etj, të zhvilluara gjatë kohës së lidhjeve të ngushta me Bashkimin Sovjetik. Një shpjegim i tillë i ngjarjeve të lartpërmendura sipas opinionit tim, ndonëse ka një bërthamë të fortë realizmi, nuk është as i plotë dhe as i mjaftueshëm. Ai zbeh në disa raste individualitetet dhe vështrimet e ndryshme të disa prej drejtuesve më të lartë të PPSH ndaj zhvillimeve politike, ekonomike dhe sociale në vend, të kushtëzuara nga rrethanat ndërkombëtare jashtë dhe brenda bllokut komunist, nga formimi dhe veçoritë e tyre individuale etj. Mendoj se lufta brenda udhëheqjes së lartë komuniste rridhte edhe nga pamundësia e sistemit komunist për të konkurruar me atë kapitalist, me pamundësinë e tij për të arritur objektivat e përcaktuara, si mirëqenia, prosperiteti dhe përmirësimi në përgjithësi i cilësisë së jetës. Komunistët erdhën në pushtet me rrugë revolucionare, nga rrethanat e Luftës së Dytë Botërore, në kushtet e ilegalitetit të fortë, të cilat ndikuan dhe farkëtuan karaktere të ashpra, të forta, dyshuese dhe konspirative, të cilët ruajtën “gjendjen e luftës” edhe në kohë paqeje. Vetë teoria e “luftës së klasave” krijonte bazën teorike për reprezalje të vazhdueshme dhe dënime në emër të saj. Kjo bazë teorike e kombinuar me cilësitë e sipërpërmendura u reflektua qartësisht në jetën e përditshme të komunistëve shqiptarë, por sidomos në rangjet më të larta të tyre duke ushqyer një paranojë permanente, e cila u materializua në spastrimet e vazhdueshme kundër “armiqve të klasës” dhe armiqve të tjerë që lindnin në Shqipëri. Por një tjetër rrethanë që favorizonte përplasjet brenda udhëheqjes së lartë të PPSH, ishte Lufta e Ftohtë dhe epërsia e botës Perëndimore, e cila ishte dhe mbeti e paarritshme për të gjitha vendet e Lindjes Komuniste.

Lufta për pushtet ka qenë një qëllim konstant në radhët e udhëheqjes së lartë të PPSH, por ky nuk ishte i vetmi qëllim dhe motiv i saj. Brenda luftës për pushtet në “Kremlinin shqiptar”, janë shfaqur edhe nënshtresa të tjera, që kanë të bëjnë me natyrën patriotike, kombëtare, me konceptimet e ndryshme të zhvillimeve socialiste etj, të cilat mund të kenë qenë të zbehta, por të pranishme në zhvillimet shqiptare të kësaj periudhe. Në këtë kuptim nuk mund të shpjegohet vetëm me motivin e luftës për pushtet, qëndrimi dhe vizioni i Sejfulla Maleshovës ndaj zhvillimeve politike dhe ekonomike të Shqipërisë së viteve 1945-1946. Po kështu, nuk mund të analizohet dhe shpjegohet rezistenca deri në vetëmohim e Nako Spirut ndaj ndërhyrjeve të Partisë Komuniste të

Jugosllavisë në Shqipëri, pa vënë në dukje edhe motivet kombëtare dhe patriotike të tij. Fundi tragjik i Nakos erdhi kryesisht për shkak të qëndrimit të tij pa kompromis ndaj jugosllavëve, të cilët donin të nënshtonin Shqipërinë dhe ta fusnin atë në “vathën” e Federatës jugosllave; të interferencave jugosllave brenda radhëve të Byrosë Politike të PKSHE dhe të qëndrimit të dyzuar të vet udhëheqësit kryesor të saj Enver Hoxhës, i cili u bë pjesë e lojës politike të jugosllavëve. Vetëvraska e Nakos ndodhi kur udhëheqja jugosllave por ia shtrëngonte “darën” shtetit shqiptar, duke dashur të finalizonte bashkimin e tij me Jugosllavinë, në rrethanat kur BS kishte dyshime të forta ndaj Jugosllavisë së Titos, sepse kjo e fundit donte të vendoste hegjemoninë e saj në Ballkan, ndërkohë që BS donte ti kishte ato nën kontrollin e vet. Po kështu, lufta dhe përplasjet e forta brenda radhëve të PPSH në vitet ‘50, nuk mund të shpjegohen pa pasur në konsideratë ndryshimet pas vdekjes së Stalinit dhe idetë liberalizuese të Hrushovit, të shfaqura në Kongresin e 20-të të PKBS. Në kuadrin e Luftës së Ftohtë, politika e Hrushovit do të sillte disa ndryshime pozitive, sepse ajo ndikonte në zbutjen e situatën së acaruar të Lindjes me Perëndimin, se favorizonte dialogun me të, se kundërshtonte kultin e individit dhe çlironte energji pozitive për zhvillimet e brendshme të vendeve ish-komuniste të Evropës Lindore dhe Qendrore. Në Shqipëri, lufta brenda radhëve të udhëheqjes së lartë komuniste u zhvillua duke pasur si referencë dhe mbështetje këto zhvillime, të cilat për fat të keq u reflektuan shumë pak në Shqipëri.

Pavarësisht nga këto opinione, unë mendoj se botimi i kësaj monografie do të jetë i vlefshëm dhe i mirëpritur për rrethet shkencore, studentore dhe për lexuesit e tjerë, të cilët do të donin të shihnin një histori të dokumentuar dhe të shkruar nga një historian profesionist. Në këtë mënyrë, ajo do t’i bënte një shërbim të mirënjohjes së një periudhe të debatueshme dhe të shkruar me parafabrikatet e historiografisë komuniste.

Hamit KABA